

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rama fton gjyqtarët në tryezë/ Çupi: Një histori që ka shkaktuar tension në publik, u treguan mizorë me paratë e shqiptarëve
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/rama-fton-gjyqtaret-ne-tryeze-upi-nje-histori-qe-ka-shkaktuar-tension-n-i586258
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 12:31:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 12:25:16 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b56ecad725e7a4a664ecb44729999e79170a01173b5ef3b4ee744d57a2d52a95
TEKSTI	4d480dff0cd127f549ea2e0cf3cd4f5981e9e638e118312b5e9981d33ac709d1
PAMJA	9fccd0c102d71501be004359ff4060ebe7d29c3e5c4e699e7cf80c21fdacf15b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	620bcccd86a5f595ee89d84224216fa59a8e27c38ccbe96d9a0f70f05c84b158
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5f8ef0f8d1c556c1a23c45b5f0b4a2927fefdb161a9dff8be1ca6faf0b0d4224
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/620bcccd86a5f595ee89d84224216fa59a8e27c38ccbe96d9a0f70f05c84b158

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie Rama fton gjyqtarët në tryezë/ Çupi: Një histori që ka shkaktuar tension në publik, u treguan mizore me paratë e shqiptarëve Rama uron Kurtin për mandatin e ri: 'Ie për fundit

Rama fton gjyqtarët në tryezë/ Çupi: Një histori që ka shkaktuar tension në publik, u treguan mizore me paratë e shqiptarëve



15 Shtator 2026, 14:25Politika TEMA



Shansi i fundit për rritjen e pagave. Kryeministri Edi Rama ka ftuar publikisht gjyqtarët, me në krye Kreun e Shoqatës së tyre, Engert Pëllumbin, të ulen në tryezë me qeverinë për të diskutuar e zgjidhur ngërçin për rritjen e pagave të drejtësisë.

I ftuar në ABC News, analisti Frrak Çupi e komentoi ashpër situatën, duke deklaruar se përplasja rreth pagave ka ndikuar në perceptimin e publikut për sistemin e drejtësisë.

Ai theksoi se me këto akte, sistemi gjyqësor ka dëmtuar besimin e qytetarëve pasi tregoi sjellje mizore ndaj parave të shqiptarëve.

"Nuk është hera e parë në botë që ndodh një gjë e tillë, jo në këto përmasa, jo me këto synime, por ka ndodhur që trupat gjyqësore të pangopura kanë përdorur mjetet e tyre dhe falsifikimin e mjeteve ligjore për të shtuar pasurinë e tyre.

Është një histori, e cila ka shkaktuar tension në publik dhe pakënaqësi shumë të madhe në publik. Ka marrë një neveri, sepse publiku e di se cilët janë dhunuesit e të drejtës. Të gjitha janë problem. Që nga procedurat dhe deri te mendimi.

Janë treguar mizore. Më përpara i kanë marrë të drejtën publike qytetarit dhe tani po ua marrin edhe paratë. Kanë rrëzuar besimin, me këtë gjë që kanë bërë. Kanë stimuluar tundimin para mëkatit. Drejtësia e ka humbur besimin me këto veprime", tha ai.

Çupi u ndal edhe te roli i kryeministrit në këtë situatë, duke argumentuar se Rama, përtej rolit të tij si kreu i qeverisë, ka përgjegjësi edhe për administrimin e buxhetit të shtetit.

"Kryeministri funksionon si kryetar i qeverisë, por edhe si kryefamiljar për buxhetin që ka shteti. Kryeministri iu hedh ftesën me qëllim që të ndihmohet drejtësia, më shumë seç mund të ndihmohet qeveria. Drejtësia ka rënë në duar të xhahilëve, që duan ta rrëzojnë sistemin e drejtësisë, Kryeministri mendon për buxhetin", pohoi ai.

Ndër të tjera, Çupi foli për procesin gjyqësor në Hagë që po mbahet ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ai tha se lirimi i Hashim Thaçit dhe i drejtuesve të tjerë do ishte një risi jo vetëm për Kosovën, por dhe për vetë botën demokratike.

“Në Kosovë qeverisin forcat anti-UÇK. Qeverisin forcat që nuk e njohin Kushtetutën, as republikën dhe qeverisin forcat që nuk njohin as flamurin e tyre. Lirimi i Hashim Thaçi do ishte risi për botën, jo thjesht për Kosovën. Do ishte një vlerë shumë e madhe”, theksoi Çupi.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Rama uron Kurtin për mandatin e ri: Të përshpejtojmë rrugëtimin drejt familjes europiane

14:20 Politika

"Pasqyrë Albania"/ Koçi: Administratë më efikase dhe më pranë qytetarëve

13:45 Politika

Gogu: Secili pushtet në vendin e vet; Kuvendi humbi afatin, por zgjidhja për pagat bëhet me ligj

13:05 Politika / 1 koment

Kryeministri Rama në Napoli, vizitë në Katedrën e Gjuhës Shqipe pranë Universitetit “L’Orientale”

12:45 Politika / 2 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.